



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI JURIDIK**

Agim Ramadani, pn., 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381-38-229 063, 220 484 • email: juridiku@uni-pr.edu • URL: <http://www.juridiku.uni-pr.edu>

Dekani:
Prof.Ass.Dr. Avni Puka

Nr.prot: 03/264
Datë: 01.06.2021

Në bazë të nenit 118 paragrafi 5 i Statutit të Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me 19.05.2021, Këshilli i Fakultetit Juridik, nxjerr:

VENDIM

Për kriteret e paraqitjes, vlerësimit dhe mbrojtjes së temave master

1. Një (1) vit para arritjes së moshës së pensionimit, profesorët nuk mund të emërohen mentor dhe anëtar të komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e temave të masterit. Për temat që profesorët janë emëruar me herët si mentor ose anëtar të komisionit, vazhdojnë deri në arritjen e moshës së pensionimit.
2. Profesori i angazhuar në mësimdhënie pas moshës së pensionimit, mund të mentoroj më së shumti pesë (5) tema të masterit për një vit akademik. Pas arritjes së moshës 68 vjeçare, profesori nuk mund të emërohet mentor apo anëtar i komisionit për vlerësimin dhe mbrojtjen e temave të masterit. Për temat që profesorët janë emëruar me herët si mentor ose anëtar të komisionit, vazhdojnë deri në arritjen e moshës 70 vjeçare.
3. Ndarja e temave të masterit duhet të bëhet në mënyrë proporcionale.
4. Katedrat duhet të respektojnë ndarjen proporcionale të mentorimit të temave master, duke i dhënë përparësi thirrjes akademike me të lartë, bazuar në një shkallëzim për shpërndarjen e temave, sipas kriterëve si: publikimet shkencore, moshë, përvoja profesionale dhe gjinia. Ndarja e temave sipas këtyre kriterëve mbikëqyret nga shefi dhe sekretari/ja i katedrës, në bazë të raportit të evidencave mujore dhe vjetore.
5. Me qëllim të ndarjes proporcionale, mësimdhënësit e katedrës janë të obliguar që të propozojnë një listë të titujve/temave master, duke respektuar parimet e pikës 4 të këtij vendimi. Numri i titujve për tema që duhet të propozohen nga mësimdhënësit caktohet në varësi të numrit të studentëve të regjistruar.
6. Propozimi i listës së temave master do të bëhet deri me 30 shtator dhe ju vihet në dispozicion studentëve të regjistruar në vitin akademik përkatës. Për studentët që aktualisht janë duke vazhduar studimet master në Fakultetin Juridik, propozimi i listës së temave bëhet brenda muajit qershor 2021.
7. Lista e propozuar me titujt e temave së bashku me emrin e mësimdhënësit që e ka propozuar miratohet në Këshillin e Fakultetit dhe publikohet në ueb faqen e Fakultetit Juridik.

8. Studentët kanë të drejtë të zgjedhin për temë të masterit njëjën nga titujt (temat) e propozuara, sipas listës së titujve të publikuar paraprakisht. Studenti/ja i/e cila përcaktohet për titullin përkatës, paraprakisht duhet të konsultohet dhe të arrijë pajtueshmëri me mësimdhënësin që e ka propozuar temën, sipas listës. Titulli i temës së propozuar në listë, mund të ndryshohet/plotësohet në konsultim me mësimdhënësin (mentorin).
9. Ndarja e temave në mënyrë proporcionale, në pajtim me këtë vendim dhe listën e publikuar mbikëqyret nga shefat dhe sekretarët e katedrave, në bazë të raportimit të rregullt për temat master të cilët propozohen në katedër dhe Këshill të Fakultetit.
10. Shfuqizohet vendimi i Këshillit të Fakultetit nr.01/253, datë 10.06.2016 dhe vendimi nr.02/34, datë 19.02.2021.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli i Fakultetit.

Kryesues i Këshillit të Fakultetit

Prof.Ass.Dr. Avni Puka - Dekan

